



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.12.2020

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2018, PËR PROJEKTIN “MENAXHIMI I MODERNIZUAR I MBETJEVE DHE EKONOMIA RICIKLUESE NË RESPEKT TË MJEDISIT (DKTI)”

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 dhjetor 2020, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (DKTI)”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë projektligj, z. Ervin Bushati.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e

Shqipërisë”.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.***

Marrëveshja, që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, është nënshkruar në tetor 2019. Ajo është hartuar në zbatim të marrëveshjes bazë për bashkëpunim teknik me Gjermaninë të tetorit 1988 për mbështetjen e projektit “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (DKTI)”.

Marrëveshja parashikon që Qeveria Gjermane të verë në dispozicion për projektin, me shpenzimet e saj, shërbime në personel dhe materiale, si dhe kontribute financimi në vlerën 4.5 milionë euro. Për zbatimin e këtij projekti, pala gjermane ka ngarkuar Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ.

Kjo marrëveshje është marrëveshje kuadër, në bazë të së cilës do të lidhen kontratat përkatëse të zbatimit dhe financimit, brenda një afati prej 4 vjetësh pas vitit të premtimit financiar. Në marrëveshjet e zbatimit dhe financimit do të përcaktohen edhe detajet e projektit.

- ***Efektet financiare.***

Nga zbatimi i këtij projektligji Republika e Shqipërisë do të përfitojë një vlerë prej 4.5 milionë eurosh për zbatimin e projektit. Efekte të tjera financiare, që rrjedhin nga kjo marrëveshje janë disa përjashtime nga taksat, tatimet e tarifrat, si dhe rimbursime, si më poshtë:

- Përjashtimi i materialeve, automjeteve, mallrave e pajisjeve, si dhe pjesëve të këmbimit, të lëvruara në kuadër të projektit, nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licencat, taksat e portit e të magazinimit dhe nga taksat e tjera publike;
- Përjashtimi i organizatës zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin nga zbatimi i kontratave;
- Rimbursimi i vlerës së TVSH-së apo i taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë për objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Vlera e TVSH-së së rimbursueshme parashikohet të jetë rreth 145 mijë euro.

- ***Diskutimi në Komision.***

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit paraqiti projektligjin, duke vënë theksin në rolin që ai do të luajë në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe të mjedisit, si dhe në zhvillimin ekonomik e social

të vendit tonë. Relatori paraqiti opinionin e tij në mbështetje të projektligjit. Më pas, Komisioni e vlerësoi projektligjin si mjaft të rëndësishëm e me përfitim për vendin tonë.

- ***Përfundim.***

Mbështetur në këto argumente, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORI

Ervin BUSHATI

KRYETARI

Arben AHMETAJ